



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-16389/2018
Kaçanik 30.05.2018

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e V (Pestë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 30 Maj 2018. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Nënkyryetari i Komunës –Ylber Bajra, drejtorët e drejtoreve komunal(Zahir Doda, Bahri Selimi, Ukshin Qallaku, Fatmir Loku, Festim Neziraj dhe Diana Reka), zyrtarët: (Fatlume Selimi, Betim Shala, Bejtulla Dalloshi dhe Kaltrina Luma). Drejtori i Zyrës Lokale, KRM “ Pastërtia” në Kaçanik, Ferat Malsiu.

Mbledhja u monitorua përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, kuorumi ekziston me u mbajtur mbledhja, kushte pune ka, andaj e hapi mbledhjen e V (Pestë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2018, data 30 Maj, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve buxhetore sipas programeve dhe kodeve të projekteve kapitale;
3. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale;
4. Propozim Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr. 0125 - 0, tokë bujqësore e klasës së 3 në Zonën Kadastrale në Kovaçec , në pronësi të Abdyl Troni;
5. Propozim vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr. 0564-0 tokë bujqësore e klasës së 3 në Zonën Kadastrale në Sllatinë , të pronës së Besim Terziu;

6. Propozim Vendimi Paraprak për marrjen e vendimit për ndryshimin e destinimit sipas Planit rregullativ të Zonë së I (Parë) dhe një pjesë të Zonës së II (Dytë) në parcelën kadastrale 516 në pronësi të Mevlude Dushkaja;
7. Propozim Vendimi për ndryshimin e destinimit sipas Planit zhvillimor komunal të parcelës kadastrale Nr. 223-1 në Zonën Kadastrale në Bob, në pronësi të Fatmir Livoreka; dhe
8. Informatë e MAPL për kualifikimin e Komunës së Kaçanikut për përfitimin e Grantit të Përformancës, në bazë të vlerësimit të shërbimeve cilësore me qytetarët e komunës, për vitin 2016.

Rendi i Propozuar i punës u shtrua në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës e,

APROVOJ

Rendin e propozuar të punës, në përbërje, 8 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e IV (Katërt) e Rregullt e Kuvendit të Komunës;

Vërejtje në Procesverbal paraqitën:

z. Ekrem Raka, Në f. 5 të diskutimi im, fjala, “akt moral”, duhet të hiqet.

z. Ekrem Kyçku, Procesverbali shihet se ka mangësi, kështu që duke u nisur nga këto arsyе, ne subjekti politik i LVV nuk do të votojmë.

z. Adnan Reka, Nuk e di a është e arsyeshme të debatohet në çdo mbledhje puna e Procesverbalit, Unë vërejtjet e mijë i kam bërë, ndërkao po shoh dekurajimin e këshilltarëve për me bërë vërejtje dhe kritika. Unë e kam inxhizimin e mbledhjes dhe mundem me argumentuar çdo fjalë që e kam thënë, sepse diskutimi im po ndryshohet duke i vendosur disa fjalë para apo pas diskutimit tim. Prandaj nisur nga kjo, unë jo vetëm sot por çdo herë do të jam kundër aprovimit të Procesverbalit, nëse gabimet e tilla përsëritën.

Kryesuesi i Kuvendit, Të çështja e Procesverbalit, është e pamundur teknikisht çdo gjë me u përfshirë, sepse edhe salla e KK teknikisht nuk i plotëson kushtet për diskutuesit. Edhe nëse bëhet incizim i mbledhjes, keni me vërtetuar edhe vet se nuk ka me dalë zëri i juaj si duhet. Jemi duke bërë përpjekje që incizimi i seancës të publikohet në Ueb Faqen të Komunës, jo drejtpërdrejtë sa është duke u mbajtur mbledhja, sepse nuk po ka mundësi menjëherë, por pas mbledhjes me atë teknikë që e kemi IT-ia ka me bërë publikimin e mbledhjes, dhe kujtoj së incizimi i mbledhjes ka me plotësuar atë që nuk mund të përfshihet në Procesverbal. Ndërkao çështje që mendoni se ka tendencia përfshirje të diskutimit apo të ndonjë pjese të tij, kjo nuk qëndron. Askush nuk besoj se ka ndonjë tendencë të tillë, kjo është vetëm nga pamundësia përfshirje të diskutimin. Incizimi i mbledhjes që realizohet përmes Teleprezencë, do të publikohet në faqen e komunës dhe do të kenë mundësi me pa çdo qytetarë. Unë, për vitin vijues kam me biseduar me shefat e grupeve parlamentare përfshirjet e sallës së mbledhjeve, ashtu si i duhet KK salla e mbledhjeve.

z. Adnan Reka, Faleminderit për tentativën që po bënë kryesues për incizimin e mbledhjes së KK, ndërkaq nëse tendencia është e vazhdueshme, atëherë unë çfarë të mendoj ndryshe, pos asaj që fshihet. Po të ishte prej fillimit një qasje pozitive që po shpresojmë se tanë e tutje do të bëhet, atëherë nuk kisha pasur ndonjë arsy me mëndu që fshihet.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK e shtroj në votim. Rezultati i votimit ishte; Për, votuan shumica, Kundër ishin 5 anëtarët nga LVV, Abstenim nuk pati. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Procesverbalit të mbledhjes së IV (Katërt) të rregullt të kuvendit të komunës Lënda: 01Nr. 60/01-12815/2018 të datës 30 Prill 2018.

Në vazhdim, Kryesuesi i Kuvendit konstatoj me kaluar në pozicionin e pyetjeve dhe kërkesave, ndërkaq kërkoi nga drejtorët të marrin shënimë me qëllim që të jalin përgjigje në mbledhjen vijuese.

PYETJE DHË KËRKESA

znj. Lirije Luta,

1. E kam një Kërkesë në emër të fshatit Ivajë, për mungesën e ujit të pjes. Ata kanë kërkuar të merren veprime të menjëhershme nga organi përkatës për zgjidhjen e problemit të ujit të pjes dhe sanimin e gjendjes së rrugës së fshatit.
2. Pyetja e dytë është, të merren veprime të nevojshme për sanimin e gjendjes se ujit të pjes në lagjen “Dushkaja”, sepse ka pasur mungesë të ujit të pjes në këtë lagje.

z. Ekrem Raka, Me intereson të di ku qëndrojnë arsyet që nuk procedua në Kuvend nga KPF, Propozim Vendimi për hapjen e rrugës, Ivajë-Shtrazë.

z. Selim Reka, Siç dihet Baseni i ujit të pjes është vendosur në pikë shumë të lartë. Me intereson të di, a është planifikuar rrjeti i ujësjellësit edhe në pikat ku nuk ka rrjet të ujësjellësit.

z. Bekim Koxha,

1. E ngriti një Ankesë të f. Doganaj, Lagija- Koxhaj për projektin e kanalizimit që është duke u ndërtuar në atë pjesë. Qytetarët e asaj lagjeje janë të pakënaqur me punimet e kompanisë dhe me mbikëqyrjes që ia ka bërë komuna këtij projekti.
2. Kemi një Kërkesë nga blegtoret e f. Doganaj, për blegtoret që shkojnë në Stane, ata nuk mund të shkojnë në Stane, sepse rruga është i pakalueshme. Ata kërkojnë që drejtoria përkatëse të merr veprime të nevojshme për rregullimin e infrastrukturës rrugore deri të Stanet.
3. Të Çerdhja e Fëmijëve ”Agimi” në Kaçanik, ka ankesa nga qytetarët e komunës se është zënë kanalizimi në atë pjesë.

znj. Nazife Krasniqi, Kërkoi të di, a janë hulumtuar Lokacione për Treg të Gjelbër, nëse jo, atëherë duhet hulumtojmë për me bërë zgjidhje të përhershme, ndërkaq shtoj se lokacioni ku

është duke e zhvilluar veprimtarinë tanë për tanë Tregu i Gjelbër, nuk ka kurrfarë kushtesh. Mendoj se është mirë t'iu krijohen sadopak kushte elementare përfunksionim e tij.

znj. Albana Troni, Në emër të f. Kovaçec, e ngriti çështjen e rregullimit të ndriçimit publik në rrugën kryesore të këtij fshati, ndërkaq theksoj së është nevojë e kohës me u realizuar ky projekt.

znj. Kaltrina Tafili, Rruga që e lidhë Kaçanikun me f. Stagovë, me konkretisht- Lagija, Dashi, është bllokuar. Me intereson të di, kur do të merrni veprime të nevojshme nga ana e organit kompetent përf瑯lokimin e rrugës në fjalë, në mënyrë që mos të ndodhë ndonjë aksident si rezultat i bllokimit të kësaj rruge.

z. Ekrem Kyçyku;

1. E ngriti një Kërkesë në emër të f. Stagovë përvërshimet që po ndodhin si rezultati i daljes nga shtrati të lumit Neredime, me çka qytetarëve po iu dëmtohen tokat pjellore përreth lumit. Banorët e fshatit, kërkojnë të shqyrtohet kjo çështje dhe krijimin e mundësive financiare përf瑯zgjerimin e shtratit të lumit. Unë kërkoi me pasur një përgjigje pozitive përbanorët e fshatit, lidhur për këtë çështje.

2. Shprehi shqetësimet e tija për Deponitë ilegale të krijuara të cilat dita ditës veç sa vijnë e shtohen. Mjafton me dalë në secilën rrugë lokale dhe me i pa se si janë duke u shtuar dita ditës deponitë ilegale të llojeve të ndryshme, si; ushqimore, materialit ndërtimor etj. Pyetja është, kur organi ekzekutiv do të merr veprime të nevojshme për heqjen dhe ndalimin e hedhjes së mbeturinave vend e pavend.

z. Adnan Reka,

1. Dëmet e shkaktuara nga reshjet e shumta atmosferike, si rrjedhojë e punimeve të Autostradës, shihet se nuk kanë të ndalur. z. Nexhat Loku pati propozuar të formohet një Komision përmes mbikëqyrurë punimet e kompanisë “Bektel Enka” dhe dëmet e shkaktuara. Më intereson të di, a është formuar ai komision nëse po, të na tregojë përpunën që po bën komisioni, nëse JO, pse nuk u formua.

2. Besoj se e keni pranuar Kryesues një Letër anonime, edhe pse është letër anonime është shqetësim i qytetarëve të komunës përmes një punësim të paralajmëruar që mendohet se do të ndodhë në kompaninë regionale të mbeturinave, KRM” Pastërtia” të, Herolinda Guri. Mua me intereson të di, a keni përgjigje rrëth kësaj, apo mendoni se është kompani regionale dhe nuk është në kompetenca të juaja kjo çështje.

3. Në rrugën “Hasan Prishtina” para komunës, disa punime janë kryer në këtë rrugë. A mendoni se kanë përfunduar punimet e këtij projekti, kur dihet gropat janë ende të pa mbuluara në këtë rrugë.

4. Në rrugën “Burim Rexha” që janë zhvilluar punime në këtë rrugë, që nga tetori i vitit të kaluar në këtë rrugë është krijuar baltë për shkak të punimeve që janë zhvilluar në këtë rrugë. Ajo që është me e keqja është së 5 familje në atë rrugë, minden me lëvizur vetëm në këmbë, për shkak të punimeve që janë tu kry, që 8 muaj. Çka ndodhë nëse ndonjërs nga këto familje ju ndodhë ndonjë fatkeqësi, dhe për shkak të punimeve nuk mund t'ju ofrohet ndihma, si do ta ndjenit veten që ajo ka ndodhur për shkak të neglizhencës suaj ?

z. Shpend Krusha, Pyetja është për drejtorin e DAK, Zahir Doda; A ka informata drejtori për nxënësit e shkollave të cilët nuk i vijojnë mësimet për shkaqe të ndryshme. A keni ndonjë listë sesa nxënës nuk i vijojnë mësimet, a i dini arsyet e mos vijimit të mësimit dhe cilat janë veprimet që do t'i merrni për parandalimin e mos vijimit të mësimit. Unë kam informata se një nxënës i një shkolle të komunës tonë nuk i vijon mësimet. A jeni të informuar për këtë rast dhe a i dini arsyet, sepse nuk guxojmë me i lënë nxënësit analfabet.

Kryesuesi i Kuvendit, Para se me kaluar në pikën e radhës, unë do ta marrë fjalën për çështjen e Letrës anonim. Unë e kam marrë letrën dhe e kam lexuar. Është shqetësim ky edhe për mua dhe për të gjithë ne. Por, përderisa letra është anונית dhe për derisa ka të bëjë me një organ tjeter dhe nuk është kjo në kompetenca të KK, unë nuk e kam pa të arsyeshme të debatoj për këtë çështje. Ajo letër iu ka drejtuar organeve kompetente dhe nëse kjo ndodhë, atëherë ne jemi të obliguar si KK t'iu drejtohemë KRM "Pastërtia" për marrjen e masave të nevojshme për këtë çështje. Konkursi ka dalë nga KRM "Pastërtia" në Ferizaj dhe ajo kompani regionale merret me këtë çështje. Nëse kjo ndodhë kjo, është shqetësim edhe për ne edhe për qytetarët e komunës tonë, ndërkaq ne çka mund të bëjmë si kuvend, për këtë rast, mund të kërkojmë llogari edhe përmes përfaqësuesve tonë të komunës të zgjedhur në atë kompani.

z. Besim Vishi,

1. Kërkoj sqarim për çështjen e Ujësjellësit në f. Dubravë, sepse thuhet se në këtë fshat nuk do të jetë rrjeti sekondar i ujësjellësit.

2. Me intereson të di për mbetjet medicinale si menaxhohen mbeturinat e tyre, si; barnat pa afat dhe mbetjet tjera, sepse janë tejet të rrezikshme. Këto mbeturina duhet ditur sesi menaxhohen, ndërkaq, shpresoj që këto mbetje të mos hedhen tek mbeturinat e përgjithshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Para se me kaluar në pikën e dytë, ata anëtarë të KK të cilët nuk i kanë marrë Llaptopët, kërkoj të shkojnë të DAP e t'i marrin, sepse tanë e tutje materialin e mbledhjeve do t'ua dërgojmë vetëm në formë elektronike. Kisha kërkuar që çështjet e emaileve etj. t'i rregulloni përmes IT. Pyetje të tjera nuk ka, atëherë kalojmë në pikën e dytë;

2. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve buxhetore sipas programeve dhe kodeve të projekteve kapitale;

Kryesuesi i Kuvendit, DEFZH i ka specifikuar projektet, sepse më herët ka qenë shqetësim i juaj se nuk po specifikohen disa nga projekte. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Te pikat; 3, 4 dhe 5 të Propozim Vendimit, shihet së janë paraparë projekte, por nuk janë specifikuar shumat për secilin projekt. Si p.sh. të Programi buxhetor, Arsim dhe Shkencë janë paraparë projektet, pro jo edhe shumat. Fjala vjen të; Gjimnazi "Skënderbeu" në Kaçanik; Rregullimi i dyshemësë dhe Sallës së sportit me linelium, nuk janë specifikuar shumat, pastaj, Rregullimi i dyshemësë me linelium, Ndërrimi i dyerve të klasave dhe shtrimi i pjesës së oborrit me kubëza në shkollën e filllore "Agim Bajrami" në f. Stagovë, edhe këtu nuk është specifikuar shuma. Gjithashtu të pika 4. Programi buxhetor, Shërbimet shëndetësore primare, nuk janë specifikuar shumat e projekteve. Njëjtë është

edhe të pika 5 të Programi buxhetor, Shërbimet publike- infrastrukturë rrugore. Duke u nisur nga këto parregullsi, ne LVV do të abstenojmë, kur kjo çështje të del në votim.

z. Ekrem Raka, Pajtohem me parafolësin tim Ekrem Kyçyku lidhur me vërejtjet të cilat i potencoj në këtë Propozim Vendim për projektet të cilat nuk janë specifikuar shumat, ndërkaq unë jam për atë që komuna me ua kthyer projektet në të mirë të qytetarëve, si në arsim, shëndetësi dhe në sektorë të tjera.

z. Adnan Reka, Të projekte e propozuara për financim në shkolla, shihet së shumat e mjeteve janë të përgjithshme, me çka edhe unë pajtohem me vërejtjet e parafolësve, ndërkaq me intereson të di për shumën e mjeteve të parapara 58.000€ që ka të bëjë me shpronësimin e pronave të paluajtshme sipas Akt-Vlerësimit nga MF dhe Vendimit përfundimtar nga komuna, për ku është fjala ky shpronësim.

z. Bahri Selimi, Në vitin 2017 kur është miratuar Buxheti i Komunës për vitin 2018, nuk i kemi pasur të nënshkruara disa Marrëveshje me Ministrinë. Në pajtim me Kërkesën e juaj e kemi sjellë këtë Propozim Vendim për specifikim të projekteve .

Shumat nuk janë specifikuar të sektori i Arsimit dhe të sektori i Shëndetësisë, sepse në shumë projekte ka me u intervenuar në këta dy sektorë. Drejtoritë i ka paramasat dhe paralogaritë, dhe për çdo informatë që iu duhet shtesë, ne do të jemi të hapur.

Të Shpronësimet, komuna përmes legjislaturës së kaluar, ka shpallë edhe Zona me interes të përgjithshëm. Vlerësimin e bënë një komision i caktuar në kuadër të MEF- departamenti i Tatimit në Pronë. Akt vlerësimet na kanë ardhur dhe kjo është arsyja pse komuna ka dalë me këtë shumë të mjeteve.

z. Besim Vishi, Projekti, Ndërtimi i trotuarit në lagjen Imisht, me intereson të di se për cilën pjesë bëhet fjalë.

z. Bekim Koxha, Të Projekti, Ndërtimi i objektit social të banimit, pika 1.2, shuma 34.397.40€, me intereson të di, si rezultat i kujt ka ardhur rritja e shumës për projektin në fjalë. A është projekti detal për ndërtimin e objektit social të banimit, apo është gjysmak projekti.

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqarime të nevojshme në këtë pyetje fjalën ia jap menaxherit të projektit, Betim Shala.

z. Betim Shala- Zyrtar në DUKMM -Sqaroj në pika të shkurtër për projektin, paramasat dhe për paralogaritë e projektit dhe si do të realizohet projekti.

z. Ukshin Qallaku, Sipas paramasave që i sqaroj menaxheri i projektit, projekti nuk ka qenë i plotë, kështu është lidhur një Marrëveshje për me financuar komuna. Në pjesën e parë është fasadimi. Për sqarime shtesë mund të drejtoheni tek DUKMM.

z. Nazife Krasniqi, Të Shuma 25.000€ për ndërtimin e dy Urave të qytetit mbi lumin, Lepenc dhe Neredime në Kaçanik dhe ndërtimin e Trotuarit në lagjen, Imisht, a formohet ndonjë Komision para se me filluar punimet këto projekte, apo pas të fillojnë punimet.

Të Programi Buxhetor; Arsim dhe Shkencë, shuma 40.000€ për financim të projekteve të përcaktuara si në Propozim Vendim për pikët; 3.1 deri në 3.9, a ka kërkesa për këto projekte nga shkollat, apo formohet komisioni me i përcaktuar projektet me prioritet.

z. Bahri Selimi, Të Programi buxhetor 17528 – Buxhet dhe Financa, nga projekti kapital i përbashkët, projektet 1.1, 1.2 dhe 1.3 janë projekte që do të realizohen me mjete për bashkëfinancim të projekteve me kod, 86245. Të ndërtimi i dy Urave të qytetit mbi lumin, Lepenc dhe Neredime, shuma 80.000€ janë nga Granti i përfomancës. Informacionet shtesë mund t'i merrni në DEFZH.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë pikën dytë, e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me 19 votë Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 5 anëtarë, ndërkaq 3 anëtarë kur kjo çështje u shtrua në votim nuk ishin prezent. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndarjen e mjeteve buxhetore sipas programeve dhe kodeve të projekteve kapitale, paraqitur si në lëndën: 01Nr. 400/01-15696/18.

3. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale;

Kryesuesi i Kuvendit, Ju e dini se sipas Rregullores të cilën e aprovuam në mbledhjen e kaluar në KK, duhet të formohen edhe Këshillat e fshatrave, lagjeve dhe vendbanimeve. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimit. Meqë nuk ka të interesuar për diskutim, atëherë shkojmë me propozime konkrete për përfaqësimin e kuvendit me dy anëtarë nga dy subjektet politike me të mëdha.

z. Nexhat Loku, Nga subjekti politik i PDK për anëtar të komisionit e propozojmë të jetë, Besim Vishi.

z. Shpend Krusha, Nga LVV, e propozoj fillimi shqiptar Ekrem Kyçiku, por ky i njëjti Kryesuesi shtoj së nuk ka të drejtë me qenë, pasi që është anëtar i KPF, atëherë nga LVV u për anëtar të komisionit u propozua, Adnan Reka.

Propozimet të cilat dolën u shtruan në votim për aprovim dhe të njëjtit u aprovuan njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale, në përbërje prej 5 anëtarëve, 2 anëtarë nga Kuvendi, 2 anëtarë nga Ekzekutivi dhe 1 anëtar nga OJQ.

Nga Kuvendi i Komunës, anëtarët të komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale u caktuan:

- 1. Besim Vishi, nga PDK dhe**
- 2. Adnan Reka, nga LVV.**

Tre anëtarët tjerë të këtij komisioni (dy nga Ekzekutivi i Komunës dhe një anëtar nga OJQ), caktohen nga Kryetari i Komunës.

4. Propozim Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr. 0125- 0, tokë bujqësore e klasës së 3 në Zonën Kadastrale në Kovaçec , në pronësi të Abdyl Troni;

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqarime të nevojshme fjalën ia jap drejtori të DUKMM, Ukshin Qallaku.

z. Ukshin Qallaku, Sqaroj se ky Propozim Vendim është Paraprak, MBPZHR vendosë në bazë të Vendimit të cilin e marrim ne se a me ia lejuar apo jo ndërrimin e destinimit kësaj prone. Zgjidhja është me u lejuar destinimin, sepse prona veç e ka ndërruar destinimin që e ka pasur për shkak të punimeve të Autostradës, dhe kështu ato prona nuk janë më bujqësore. Në të ardhmen, ne po planifikojmë që ato prona me Harta Zonale me i shndërruar në pronë ndërtimore.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjuat sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutim:

z. Bekim Koxha, Unë nuk e di si e ka lejuar DUKMM me u degraduar tokat nga kompania e cila po i kryen punimet e Autostradës,” Bektel Enka”. Kjo është devijim i drejtorit që ka lejuar me u degradua tokat me të mira bujqësore në komunë. Kjo është edhe papërgjegjësi e inspektorit përkatës që ka lejuar me u degraduar këto prona.

z. Ukshin Qallaku, Së pari duhet me kuptuar çka është Autostrada dhe projekt i kujt është. Ai është projekt nacional dhe ne absolut nuk mundemi me ia ndalur punimet kompanisë “Bektel Enka”, ndërkaq për çështjen e pronave, pronat private janë të shenjta, secili është zot në pronën e vet dhe vepron me pronën e tij ashtu siç donë vet.

Kryesuesi i Kuvendit, Pronat private janë private, janë të shenjta, ndërkaq kërkesa për ndërrim destinimi është me Kërkesën e palës. Pronave nuk mundet me iu ndërruar destinimi pa Vendim të KK, ndërkaq njerëzit kanë nevojë për ndërtim dhe zhvillim. Nëse një vend ka qenë më herët tokë bujqësore, ndërkaq më vonë ka ndërtimë në atë pjesë, Ligi për Tokën Ndërtimore e lejon që ajo tokë të kthehet në tokë ndërtimore. Ne e dimë se pronat në Kovaçec janë bujqësore, mirëpo, vendi duhet me u zhvilluar, atëherë shtrohet pyetja nga ka me u zhvilluar, nëse ne nuk i lejojmë ato prona me i shndërruar në toka ndërtimore. Nëse ka bazë ligjore me u bërë ky ndërrim destinimi, ne nuk mund t'i pengojmë palët mos me ua ndërruar destinimin pronave të tyre, ndërkaq nëse është në kundërshtim me ligjin, ajo është diçka tjetër. Prona është e klasës të 3-të, vlerësimet janë bërë edhe nga një komision i komunës, fillimisht duhet të merret një Vendim Paraprak nga KK, pastaj bëhen vlerësimet nga një komision i Ministrisë së Bujqësisë dhe nëse kjo ministri e jep Pëlqimin, atëherë KK duhet të merr Vendimin Përfundimtar. Ne gjatë tërë vitit kemi më u përballë me kërkesa të kësaj natyre, kështu është mirë që aty ku mendojmë se janë të arsyeshme për shkak së janë në afërsi të pronave të banueshme, atëherë pse t'i pengojmë. Ne në bazë të kopjeve të planeve, fletave poseduese e dimë se ku janë këto prona, e kemi edhe vlerësimin e komisionit të brendshëm, e kemi arsyetimin e drejtorisë. Këto janë të dhënat në bazë të cilave ne vendosim.

Meqë nuk ka kush diçka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u miratua me shumicën e votave Për, Kundër ishte, Bekim Koxha, Abstenime nuk pati. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr. 0125- 0, tokë bujqësore e klasës së 3 në Zonën Kadastrale në Kovaçec, në pronësi të Abdyl Troni.

5. Propozim Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr. 0564-0 tokë bujqësore e klasës së 3 në Zonën Kadastrale në Sllatinë , të pronës së Besim Terziu;

Kryesuesi i Kuvendit, Unë vijë nga ajo pjesë dhe e dijë destinimin e asaj prone. Është një pronë rreth lumit Lepenc, atë pronë, pronari mendon me e shfrytëzuar për zhvillimin e turizmit. Shtrohet pyetja , a kemi arsyе ta pengojmë këtë ndërrim, ku pronari mendon me e zhvilluar një biznes. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Shpend Krusha, Me intereson me ditur së ku gjendet lokacioni i asaj prone.

Kryesuesi i Kuvendit, Prona është afër një ure të hekurit, afër urës së Banovinë, të një Verrishte. Ajo tokë edhe me herët është shfrytëzuar për rekreacion. Edhe kjo pronë ka trajtim të zhvillimit dhe kujtoj se është e arsyeshme me u aprovuar ndërrimi i destinimit të saj.

z. Besim Vishi, Sqarimet u dhanë lidhur me këtë Propozim Vendim për veprimtarinë që donë me zhvilluar pronari në atë pronë, por kujtoj se është dashur të specifikohen në lëndë arsyja, sepse Besimi Tërziu sa e di unë merret me gurthyes dhe është mirë kjo të sqarohet.

Kryesuesi i Kuvendit, Ky është Vendim Paraprak dhe Pëlqimi jepet nga Ministria e Bujqësisë, ndërkaq për gurthyes leja duhet të merret në komunë.

z. Ukshin Qallaku, Vlerësimin e pronës e bënë Ministria e Bujqësisë në bazë të vendimit të KK,, ndërkaq pas Vendimit përfundimtar të KK, ai e merr një Leje ndërtimore nga DUKMM dhe në aty përcaktohen të gjitha kushtet të cilat duhet t'i plotësoj pala për ndërtimin e objektit në fjalë, ndërkaq me brengosë fakti që z. Koxha është kundër ndërrimit të destinimit.

z. Bekim Koxha, Aty është dashur me intervenuar me herët që “Bektel Enka” mos me hedhur “dhe” në atë pjesë, sepse tanë është bërë vonë.

znj. Albana Troni, Edhe unë kam dashur me ngritur këtë çështje, por ishte edhe Kérkesë e f. Kovaçec, lidhur me dheun e hedhur në atë pjesë.

Kryesuesi i Kuvendit, Tërheqë vërejtjen diskutueseve të fundit se keni dalë jashtë rendit të ditës, ne jemi duke debatuar për një pikë tjetër, ndërkaq po debatoni për pikën e përfunduar. Atëherë, meqë nuk ka kush diçka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim. Kur u votua kjo çështje në sallë ishin 25 anëtarë. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për i anëtarëve prezent. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë,

Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr. 0564-0 tokë bujqësore e klasës së 3 në Zonën Kadastrale në Sllatinë , të pronës së Besim Terziu.

6. Propozim Vendimi Paraprak për marrjen e vendimit për ndryshimin e destinimit sipas Planit rregullativ të Zonë së I (Parë) dhe një pjesë të Zonës së II (Dytë) në parcelën kadastrale 516 në pronësi të Mevlude Dushkaja;

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqarime të nevojshme falën ia jap drejtorit të DUKMM, Ukshin Qallaku.

z. Ukshin Qallaku, Sqaroj se kur është bërë Plani urbanistik, ajo pjesë ka qenë me plan Qendër rekreative- sportive. Qëllimin i ndërrimit të destinimit të pronës në fjalë, është se pronari ka oferta për atë lokacion për qëllim biznesi, ndërkaq me Harta Zonale mund të bëhet ajo pronë për qëllime biznesi. Kjo është në interes edhe të pronarit edhe të komunës tonë, sepse aty do të bëhen disa punësime.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka, Për këtë pikë e hapi diskutimi; Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprova njëzëri. Në kohën kur u shtrua në votim kjo çështje, në sallë ishin 24 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr. 0564-0 tokë bujqësore e klasës së 3 në Zonën Kadastrale në Sllatinë , të pronës së Besim Terziu.

7. Propozim Vendimi për ndryshimin e destinimit sipas Planit zhvillimor komunal të parcelës kadastrale Nr. 223-1 në Zonën Kadastrale në Bob, në pronësi të Fatmir Livoreka

Kryesuesi i Kuvendit, Në këtë pikë fjalën ia jap drejtorit të DUKMM, Ukshin Qallaku, për sqarime të nevojshme.

z. Ukshin Qallaku, Sqaroj se kjo zonë nuk ka plan detal urbanistik, është P+2, tani mendohet të kaloj në P+5. Kërkesa është nga pronari, ndërkaq dihet se nuk kemi hapësira tjera për ndërtim të objekteve publike. Ne jemi me u ndërtuar objekti ashtu si kërkohet, për mos me shkuar diku tjetër investimi i ndërtimit të tij. Arsyja është se çmimi i tregut të banesave në komunën tonë është me i lartë se në gjithë vendet tjera të Kosovës. Kështu ne pasi nuk kemi hapësira tjera në qytet, kemi menduar që ajo pjesë t'i rritet etazhitët nga P+2 në P+5 . Kërkesa është nga pronari, prona është e mjaftueshme, në afërsi të asaj prone është një objekt. Ne jemi me u ndërtuar ky objekt, në mënyrë që qytetarët e komunës tonë mos të shikojnë për zgjidhje të banimit në komunat tjera.

Kryesuesi i Kuvendit,.. I dëgjuat sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçiku, Është mirë se pari të merret ,Vendimi për ndryshim të planit zhvillimor, pastaj t'i jepet Leja, sepse këtu kemi të bëjmë me revidim të planit.

z. Selim Reka, Pasi ka me u bërë Revidimi i Planit zhvillimor, atëherë nuk e di pse po na ngutet kjo punë, pse mos me pritur derisa të bëhen ndryshimet e planit. Unë mendoj që ky Propozim Vendim për momentin duhet të prolongohet, për arsyet e theksuara.

Kryesuesi i Kuvendit, Në afërsi të lokacionit ku mendohet me u ndërtuar ky objekt, është një ndërtim i tillë, kështu duke u nisur nga kjo, kërkoi mirëkuptimin tuaj, sepse kjo shkon edhe në llogari të komunës, sepse jemi e vëtmja komunë që nuk përfitojmë nga zonat industriale. Ne jemi thirrur në, Kërkesën e pronarit, sigurisht se ai ka ndonjë ofertë për këtë çështje, për një ndërtim ta quaj të lartë, P+5. Aty afér është një banesë me e madhe ndoshta se kjo që po kërkohet me u ndërtuar. Për këtë arsy, unë kërkoi mirëkuptim e mos t'i kthejmë palës ofertën që e ka, sepse me vonë edhe nëse i lejohet, pala nuk dihet se a do ta ketë ofertën që e ka sot, ndërkaq jemi e vëtmja komunë që po i pengojmë ndërtimet. Ne duhet të bëjmë përpjekje t'i mbajmë qytetarët tanë brenda komunës

Kryetari i Komunës, U votuan tri vendime të një natyre, ndërkaq unë nuk e di për këtë përsë po iu pengon kjo punë për këtë Propozim Vendim. Ne e dimë se përballë shtëpisë së Shëndetit është një banesë e ndërtuar. A është mirë apo jo nuk e di ai ndërtim, por disa njerëzve iu ka bërë zgjidhjen e çështjes së banimit- afér 40 familjeve. Ne kemi marrë edhe vendime të tjera ku e kemi ndryshuar Plani zhvillimor komunal, siç ke tani një vendim ku iu ndërruar destinimi pronës për çështje e bizneseve. Nevojat nganjëherë të bëjnë me shkelur ligjin nga pak, por koha e tregon se a ka qenë e nevojshme aty me u ndërtuar objekt apo jo, sepse njerëzit kanë nevojë për zgjerim. Unë jam për, sepse zgjidhet çështja e banimit të disa familjeve dhe ajo pjesë do të jetë P+5 e jo P+2. Hartat Zonale do të bëhen me vonë, e ndoshta po shkon një kohë deri sa të bëhen. Sa i përket kritereve, mos dyshoni në kritere se ato i cakton drejtoria e Urbanizmit, ndërkaq mos të bëhem ne pengesë e këtij projekti, as si kuvend e as si ekzekutiv i komunës. Në fund të fundit ju jeni ata që vendosni se a e lejoni këtë ridestinim apo jo. Për këtë duhet të mendoni mirë për qytetin e juaj dhe qytetarët e komunës tuaj

z. Ekrem Kyçyku, Pikit tjetra i aprovuam, por nuk kanë të bëjnë me ndryshimin e PZHU, ndërkaq të kjo pronë, çështja është me ndryshe, sepse ndryshohet Plani zhvillimor i komunës, kjo është arsyja.

Kryetari i Komunës, Edhe objekti banesor pranë QKMF nuk ka qenë me Plan zhvillimor, a është bërë mirë apo keq, koha e tregon atë.

Kryesuesi i Kuvendit, Në aspektin ligjor KK ka të drejtë të ndërhyjë në Planin Zhvillimor. Planet zhvillimore i kanë bërë 10 vjet afat dhe kemi të drejtë me bërë ndërhyrje me bërë ndryshime. Ne, pak me herët bëmë ndërhyrje të një pronë e cila u destinua për asafizëm, ndërkaq ne nuk po kërkojmë me çdo kusht që kjo çështje të kaloj, sepse në fund të fundit interesit është i qytetarëve. Kur kemi mundësi të krijojmë hapësira për zhvillim, atëherë t'iu hapim rrugë qytetarëve të komunës tonë e mos të bëhem pengesë në këtë drejtim. Dihet se ne jemi zonë e vogël dhe nuk kemi ndonjë hapësirë se nga të zhvillohem. Kështu kisha kërkuar mirëkuptimin tuaj në këtë drejtim, megjithatë e juaja është si vendosni.

z. Besim Vishi, Unë në parim jam Për, ndërkaq me intereson të di, a ka të drejtë komuna me i kushtëzuar ndërtimet banesore, për çështjen e ndërtimeve të parkingut të banesave, në mënyrë që banesat kolektive të banimit me pasur pjesën e parkingut të veturave.

Kryesuesi i Kuvendit, Ne jemi duke debatuar për çështjen e ndërrimit të destinimit, ndërkaq çështja e parkingut etj. të ndërtimeve banesore është e caktuar me ligj. Sa i përket kritereve, kriteret i cakton drejtoria e Urbanizmit, kuptohet ashtu si i parasheh Ligji për Ndërtim, sepse pa u përmbrushur kriteret e përcaktuara sipas ligjit në fuqi, pala nuk mundet ta merr as lejen ndërtimore. Meqë nuk ka kush diçka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 13 votë Për, Kundër ishin 5, Abstenuan 6. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndryshimin e destinimit sipas Planit zhvillimor komunal të parcelës kadastrale Nr. 223-1 në Zonën Kadastrale në Bob, në pronësi të Fatmir Livoreka.

8. Informatë e MAPL për kualifikimin e Komunës së Kaçanikut përfitimin e Grantit të Përformancës, në bazë të vlerësimit të shërbimeve cilësore me qytetarët e komunës, për vitin 2016.

Kryesuesi i Kuvendit, Këtë Informatë na ka dërguar MAPL, ku na ka njoftuar për të arriturat dhe ngecjet e komunës. Bëhet fjalë për vitin aktivitetin e komunës në vitin 2016 dhe në bazë të arriturave, komuna ka përfituar Grantin e përformancës, Këtë informatë ua kam sjellë në saje të vullnetit të mirë dhe për çdo Informatë, Raport etj. që na vjen nga MAPL, do t'i u njoftojmë për shkak të transparencës. Materiali është pak i dobët me u lexuar, por kështu na ka ardhur. Për këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Është për t'u përshëndetur Granti i përfurmancës, ndërkaq ne duhet të evidentojmë dobësitë, në fushat të cilat nuk kemi përformancë të mirë. Ne kemi pasur mundësi me fituar pikë edhe në fusha tjera, si të Raporti i auditorit të brendshëm. Raporti i auditorit të jashtëm është shqyrtuar, ndërkaq Raporti i auditorit të Brendshëm, nuk është shqyrtuar. Pikë të tjera kemi pasur mundësi me fituar edhe të menaxhimi i burimeve njerëzore. Në fushat të cilat nuk kemi marrë pikë, në të ardhmen duhet të punohet me shumë.

Kryesuesi i Kuvendit, Shumë informata nuk kanë mundur me u përcjellë edhe pse kanë ekzistuar, por në mungesë të informimit, janë regjistruar të parealizuara dhe nuk kemi marrë pikë.

z. Shpend Krusha, Të Tabela me Nr. 1. pika 2, shihet se ka ngecje në vitin 2016 në realizimin e shpenzimeve të buxhetit final të Programi buxhetor, Investime kapitale. Kjo ngecje e realizmit jo shumë i kënaqshëm, po të bënë me kuptuar se buxheti ka pasur mungesë të menaxhimit të mirë.

Kryesuesi i Kuvendit, Granti është shpenzuar, ndërkaq ato janë mbetjet nga të HVK, dhe nga projektet të cilat janë bartur mjetet e ngelura në vitin vijues. Në fushën e shpenzimeve buxhetore të Programi i investimeve kapitale, jam i bindur së më mirë se të gjitha komunat tjera.

znj. Pranverë Loku-Zharku- Nga një punëtori e cila u zhvillua për këtë çështje, unë isha prezentë dhe aty e kuptova se disa indikator si rezultat i vendimmarries të çështja e barazisë gjinore në ekzekutivin e komunës etj. kemi humbur pikë. Kërkoi që këto kritere të përmbrushën në të ardhmen, ndërkaq e përgëzoj Kryetarin e Komunës dhe të gjithë akterët tjerë të komunës që në saje të aktiviteteve të tyre u përfitua ky grant.

Kryesuesi i Kuvendit, Kushti kryesor me përfituar grantin e përformancës ka qenë, Raporti i Auditorit të jashtëm, i pamodifikuar me theksim të çështjes dhe aktivitete të tjera të plotësuara. Komuna e jonë e ka përmbushur këtë kriter dhe disa kritere të tjera dhe e ka përfituar këtë grant. Kjo është sa për informacionin tuaj. Pasi nuk ka diskutime të tjera, iu njoftoj se kjo Informatë nuk del në votim, kështu konstatoj se Kuvendi i Komunës u ,

NJOFTUA

Me Informatë e MAPL për kualifikimin e Komunës së Kaçanikut për përfitimin e Grantit të Përformancës, në bazë të vlerësimit të shërbimeve cilësore me qytetarët e komunës, për vitin 2016.

Në fund, Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli,i njoftoj anëtarët e KK se nga mbledhja vijuese, materialin e mbledhjeve do ta merrni vetëm në formë elektronike.

z. Ekrem Raka, Sa i përket materiali të mbledhjeve, përpos në formë elektronike, ne duhet të marrim të njëtin edhe në kopje fizike.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka të interesuar me marrë materialin e mbledhjes në kopje fizike, nuk ka problem. Atëherë ai i cili dëshiron me marrë kopjen fizike, duhet me dorëzuar Laptopin dhe ia dërgojmë materialin e mbledhjes në kopje fizike.

z. Shpend Krusha, Për çështjet të cilat i adresohemi organit kompetent, si çështje buxhetore etj. përgjigjen kërkojmë t'i marrim direkt nga organi përkatës, Kryetari i Komunës apo drejtori i DEFZH e jo nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, Unë në kuvend, nuk mundem me i mbrojtur bindjet partiake. Unë e mora fjalën me dhënë sqarime të nevojshme për hir të korrektësisë.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu Kryesuesi i Kuvendit në ora: 12:30, e konstatoj mbledhjen të përfunduar. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 25 anëtarë. Anëtarët Sali Malsiu dhe Lirije Luta, me lejen e Kryesuesit të Kuvendit, shkuan me herët nga mbledhja.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu
Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 207);**

nga Mbledhja e V (Pestë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2018, mbajtur me 30 Maj 2018.

1. Kemal Mërseli....., _____,
2. Hamid Guri....., _____,
3. Ahmet Luma , _____,
4. Kadri Krivenjeva,....., _____,
5. Besim Vishi,....., _____,
6. Sali Malsiu....., _____,
7. Lirije Shurdhani....., _____,
8. Pranverë Loku- Zharku....., _____,
9. Lirije Luta....., _____,
10. Vlora Dalloshi....., _____,
11. Nexhat Loku, _____,
12. Shpend Krusha....., _____,
13. Adnan Reka....., _____,
14. Ekrem Kyçyku....., _____,
15. Fatijona Kyçyku....., _____,
16. Kaltrina Tafili, _____.
17. Selim Reka....., _____,
18. Besnik Salihu,....., _____,
19. Nazife Krasniqi....., _____,
20. Arlinda Rakoci-Raka....., _____,
21. Shemsedin Luzha....., _____,
22. Albana Troni....., _____,
23. Afërdita Shehi,....., _____,
24. Hajredin Luta....., _____,
25. Hafize Sallahi, _____,
26. Bekim Koxha....., _____,
27. Ekrem Raka,....., _____,